



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
GRAMSH

Nr. 1014/2.prot

Gramsh, më 26/05/2020

Vendim

Nr. 79, datë 30.04 2020

Mbi miratimin e programit 5-vjeçar për strehimin social në bashkinë e Gramshit (2020-2024).

Këshilli i bashkisë Gramsh në mbledhjen e tij të datë 30.04.2020, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga drejtoria e shërbimeve me sipërmarrje, transporteve, strehimit dhe emergjencave civile_Mbi miratimin e programit 5-vjeçar për strehimin social në bashkinë e Gramshit (2020-2024), bazuar në **ligjin nr.22/2018**, "Për strehimin social", neni 73, pika 2, shkronja b, të **VKM nr.384**, dt.12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", të **VKM nr. 453**, dt.03.07.2019, "Për masën e subvencionimit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët me kredi të lehtësuar nga shteti", **nr.454**, dt.03.07.2019, "Për kriteret dhe procedurat e përfitimit të dhënies së granteve konkurruese për përmisimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese", **nr.458**, dt.03.07.2019, "Për procedurën e kthimit në fond banese, me qëllim strehimi, të objekteve pronë shtetërore, që përfshihen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore me grante konkurruese nga buxheti i shtetit", **nr.459**, dt.03.07.2019 "Për rregullat për administrimin e kërkesave të njërive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njërive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin", **nr.823**, dt.18.12.2019, "Për procedurën e blerjes së banesave në tregun e lirë, që i shtohet fondit publik të banesave sociale me qira", **nr.522**, dt.25.07.2019, "Për metodikën e llogaritjes së masës së qirasë për banesat sociale me qira", **nr.814**, dt.03.12.2004, "Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit", të Udhëzimit të MFE, **nr.31**, datë 18.11.2019, "Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit", si dhe të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 8, pika 2;

Vendosi:

- I. Të miratojë programit 5-vjeçar për strehimin social në bashkinë e Gramshit për periudhën 2020-2024.
- II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen kryetari i bashkisë, drejtoria e shërbimeve me sipërmarrje, transporteve, strehimit dhe emergjencave civile, drejtoria e

planifikimit,zhvillimit të territorit dhe burimeve natyrore,drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar.

III. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Konc.E.Mema

Miratoi :G.Lena

Dosja nr. _____

Afati _____

Sekretari i Këshillit të Bashkisë

Endri MEMA



Kryetari i Këshillit të Bashkisë

Greta LENA

